



### **Situata Juaj**

A rriheni, kërcënoheni, ofendoheni ose kontrolloheni nga partneri Juaj? A fletë ai për atë që do t'ju marrë jeten apo t'ju marrë fëmijët? A vuajnë edhe fëmijët tuaj? Apo keqtrajtoheni nga familjaret? A mendoni nganjëherë të ikni nga shtëpia, sepse nuk e duroni dot situatën? Mirëpo nuk e dini si dhe ku të shkoni?

### **E drejta Juaj**

Ju keni të drejtë të largoheni – bashkë me fëmijët tuaj – nga shtëpia në raste kërcënuese! Mungesa e të hollave nuk është arsye penguese për hyrjen në shtëpinë e grave. Organizata për ndihmën e viktimave ose zyra përgjegjëse për çështjet sociale ju ndihmojnë financiarisht në rast nevojë. Ne bashkë me Ju sqarojmë këtë.

### **Shtëpia për strehimin e grave ju ofron**

**Këshilla nëpërmjet telefonit.** Ne jemi të arritshëm për Ju në çdo kohë në numrin e telefonit **041 360 70 00**. Ne ju dëgjojmë dhe ju ndërmjetësojmë adresat e mjekëve dhe mjekëve, këshillimoreve dhe avokatëve/avokateve ose planifikojmë bashkë me Ju hyrjen tuaj në shtëpinë për gra.

**Mbrojtje dhe siguri:** Ju te ne gjeni strehim dhe ndihmë të përkohshëm.

Adresa jonë është sekrete.

Ju keni kohë për të menduar planet për të ardhmërinë tuaj. Specialistet ju informojnë, këshillojnë dhe ndihmojnë në hapat e mëtejshëm.

Ju banoni bashkë me gra dhe fëmijë tjerë që kanë përvoja të njëjta. Shtëpia e grave ju ofron vend grave të rritura (dhe fëmijëve të tyre) pavarësisht nga përkatësia kombëtare apo të ardhurat e tyre.

### **E rëndësishme**

Nëse vini në strehimoren e grave sillni me vete sipas mundësive, dëshmi nga mjeku, dokumentet personale, kartelën e bankës dhe gjërat tuaja të rëndësishme personale, po ashtu edhe lodrat e preferuara dhe gjësendet shkollore për fëmijët tuaj.